



BASHKIA
TIRANË



Drejtuar: Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “GSM” shpk & “COLOMBO” shpk

Adresa: Rruga “Vlorë”, tek Rrapi, Ujë I Ftohtë, Vlorë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit e zgjedhur në bazë të Nenit 30 të Ligjit Nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu IV, Neni 33 është **“Procedurë e Hapur”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës **”Rehabilitimi dhe Instalimi i Sistemit të Ngrohjes i shkollës 9-vjeçare ”Mihal Grameno”**, duke realizuar rehabilitimin dhe instalimin e sistemit të ngrohjes në shkollën 9- vjeçare ”Mihal Grameno”, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit

Nr. Ref. 71244 – 05- 24- 2018

Fondi limit: **63.025.697** (gjashtëdhjetë e tremilion e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH.**

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës VKB Nr. 132, datë 21.12.2017, për “Miratimin e Programit buxhetor afatmesëm 2018 – 2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018, konfirmuar nga prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr.prot.5595/5 datë 08.01.2018.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **datë 26.06.2018 , ora 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike** datë 28.05.2018

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “Bahas” shpk me nr. NUIS J61827083D

Vlera e ofertës pa TVSH = 58.203.338 (pesëdhjetë e tetë milion e dyqind e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë**

2.Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “GSM” shpk & “COLOMBO” shpk, me nr. NUIS L26804206O & J82916489E

Vlera e ofertës pa TVSH **48.542.021** (dyzet e tetë milion e pesëqind e dyzet e dy mijë e njëzet e një) lekë.

3.Operatori Ekonomik “Leon Konstruksion” shpk, me nr. NUIS K71820009I

Vlera e ofertës pa TVSH, **53.571.712,79**(pesëdhjetë e tre milion e pesëqind e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë presje shtatëdhjetë e nëntë) lekë.

4. Operatori Ekonomik “Inerti” shpk, me nr. NUIS J66926804L

Vlera e ofertës pa TVSH, **54.077.154** (pesëdhjetë e katër milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër) lekë

5. Operatori Ekonomik “SENKA” shpk, me nr. NUIS J94808405Q

Vlera e ofertës pa TVSH, **53.429.496** (pesëdhjetë e tre milion e katërqind e njëzet e nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë

6. Operatori Ekonomik “SULOLLARI ” shpk

Vlera e ofertës pa TVSH Vlera e ofertës pa TVSH **0** (zero) lekë

7. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Vllaznia Ndërtim” shpk “Ndregjoni” shpk, me nr. NUIS K77524909Q & K31329048I

Vlera e ofertës pa TVSH **52.574.757** (pesëdhjetë e dy milion e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

1- Oferta e Operatorit Ekonomik “Bahas” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Operatorit Ekonomik “Bahas” shpk nuk plotëson pikën 6.1 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit

Operatori Ekonomik “Bahas” shpk nuk ka paraqitur në përmbushje të kriterit të mësipërm asnjë punonjës me kategori të IV (katërt), Operatori Ekonomik ka paraqitur vetëm 4 (katër) punonjës me kategori të I (parë) nga 5 (pesë) të kërkuar dhe Operatori Ekonomik ka paraqitur vetëm 2 (dy) punonjës me kategori të III nga 4(katër) të kërkuar, ashtu sic edhe është kërkuar në dokumentat Standarte të Tenderit.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të kualifikimit pika 6 është I paplotë , për rrjedhojë i pavlefshëm

Operatori ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohet pasi të ketë përmbushur të gjitha kriteret që AK i vlerëson të nevojshme.....

b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë**, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2- Oferta e Operatorit Ekonomik “Leon Konstruksion” shpk

Operatorit Ekonomik “Leon Konstruksion” shpk, nuk plotëson pikën 1 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 1 citohet:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 10).

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ndër të tjera edhe një mjet “Fadrome me goma “ Në përmbushje të këtij kriteri, Operatori Ekonomik “LEON Konstruksion” shpk, ka deklaruar në shtojcën 10 “Fadromë me goma” me targa AA 904JA, me kontratë qeraje nr.3062 Rep. Dhe nr.906 Kol.

Për mjetin “Fadromë me goma” me targa AA 904JA, Operatori Ekonomik ka paraqitur dokumentacionin përkatës të skaduar, konkretisht: certifikatën e kontrollit teknik të skaduar dhe ka paraqitur siguracionin e mjetit të skaduar.

Mosplotësimi i këtij kushti bie në kundërshtim me “Kriteret e veçanta për kualifikim”, kapaciteti Teknik pika 1, gërma (a) ku citohet:

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, me pikën 1 është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3- Oferta e Operatorit Ekonomik “SULLOLLARI” shpk me vlerë të ofertës 0 (zero) lekë pa TVSH

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “SULLOLLARI” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 10, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave.

Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “SULLOLLARI” Sh.p.k s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 10, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4- Oferta e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Vllaznia Ndërtim” shpk “Ndregjoni” shpk

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Vllaznia Ndërtim” shpk “Ndregjoni” shpk

nuk plotësojnë pikën 6.1 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit

Në pëmbushje të këtij kriteri, BOE, ka paraqitur vetëm 3(tre) punonjës me kategori të III nga 4(katër) të kërkuar.

Në pëmbushje të këtij kriteri, BOE, nuk ka paraqitur 2 (dy) punonjës me kategori të IV

Në pëmbushje të këtij kriteri, BOE, nuk ka paraqitur 1 (një) punonjës me kategori të V(pestë), ashtu sic edhe është kërkuar në dokumentat Standarte të Tenderit.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë lidhur me Kriteret e Veçanta të kualifikimit pika 6 është I paplotë , për rrjedhojë i pavlefshëm.

Gjithashtu BOE të mësipërm , nuk plotësojnë pikën 1 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 1 citohet:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 10).

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihen në dispozicion katër **Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion)** për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi.

Nga verifikimi në sistem i dokumentacionit të paraqitur, u konstatua se: Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Vllaznia Ndërtim” shpk “Ndregjoni” shpk, nuk ka paraqitur asnjë mjet Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion (gjithsej 4 (katër) copë).

Operatori ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohet pasi të ketë përmbyllur të gjitha kriteret që AK i vlerëson të nevojshme.....

b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik lidhur

me shtojcën 10, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.07.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur ankesë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik “GSM” shpk & “COLOMBO” shpk**, me nr. NIPTI L26804206O & J82916489E **me adresë:** Rruga “Vlorë”, tek Rrapi, Ujë I Ftohtë, Vlorë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH **48.542.021** (dyzet e tetë milion e pesëqind e dyzet e dy mijë e njëzet e një) lekë, **është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do ju konfiskohet sigurimi i ofertës(nëse është kërkuar), siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006, (i ndryshuar).